



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 92 Prot.

Tiranë më 23/01/2015

REKOMANDIM

Nr. 06, datë 23/01/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.184, datë 29/10/2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u realizua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, **Byroja Shqiptare e Sigurimit** me objekt;

- *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave personale” i ndryshuar, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Kontrolluesi “Byroja Shqiptare e Sigurimit” është person juridik, ent publik jofitimprurës dhe përmbush funksionet e veta në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, Statuti i themelimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Rregulloret e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Rregullore e Këshillit të Byrove, etj.

Anëtarë të “Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të licencuara që ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimit sipas legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Byroja Shqiptare e Sigurimit është anëtare e organizmit ndërkombëtar, Këshilli i Byrove me qëndër në Bruksel dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga anëtarësia në këtë këshill. Byroja mbikëqyret në punën e saj nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Në ushtrim të veprimtarisë dhe funksioneve të veta, kontrolluesi “Byroja Shqiptare e Sigurimeve”, administron **Fondin e Kompensimit** dhe **Fondin e Kartonit Jeshil**, mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore lidhur me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, furnizon, anëtarët (shoqëritë e sigurimit) me Çertifikata Ndërkombëtare Sigurimi, (kartonë jeshilë), sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli i Byrove, kryen funksionet e Byrosë trajtuese, paguese dhe të shërbimit, në përputhje me parashikimet e Rregullores së Brendshme dhe marrëveshjeve të ndryshme, kryen përfaqësimin ose lëshon autorizim përfaqësimi në procese gjyqësore ndaj Byrosë dhe për pasojë mbledh, përpunon, ruan, komunikon, transferon të dhëna personale, të subjekteve të të dhënave.

Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që kontrolluesi përpunon janë:

- individë të ndryshëm përfitues dëmsh,
- individë, shkaktarë dëmsh,
- ekspertë vlerësues dëmsh shëndetësore dhe materiale,
- punonjës të Byrosë dhe anëtarë të asamblesë.

Kategoria kryesore e subjekteve të të dhënave personale janë *individët përfitues apo shkaktarë të dëmeve të përfshirë në një aksident automobilistik*. Të dhënat personale mbledhen prej kontrolluesit gjatë krijimit të praktikave për trajtimin e “*rastit të sigurimit*”, kur Byroja është kompetente për trajtimin e tyre, për “*fondin e kompensimit*”, kur aksidenti shkaktohet nga mjete të pasiguruara apo të paidentifikuara, për “*fondin e kartonit jeshil*”, kur aksidentet shkaktohen nga mjete me targim të huaj, me policë sigurimi karton jeshil, si dhe në rastet e rimbursimit të dëmeve (paditë e regresit, nëpërmjet ndjekjes së rrugës gjyqësore).

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale sensitive, nga ana e kontrolluesit bazohet kryesisht në detyrimet që rrjedhin prej ligjit organik të tij, Nr. 10076, datë 12.2.2009, “*Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit*”.

Gjatë kontrollit u konstatua se “Byroja Shqiptare e Sigurimit” mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale dhe sensitive **në rrugë manuale**, nëpërmjet krijimit të dosjeve fizike, për subjektet e të dhënave personale individë/klientë, në rastet e çeljes së praktikave të dëmshpërblimit shëndetësor, material dhe praktikave të rimbursimit (në rrugë gjyqësore), dosjeve fizike të subjekteve të të dhënave “*punonjës*”, si dhe trajtimi dhe përpunimi **në rrugë elektronike**, i të dhënave nëpërmjet sistemeve elektronike që përdor kontrolluesi.

BSHS ka në funksion, një program të brendshëm të etiketuar si, “Sistemi i trajtimit të dëmeve”. Administrator i këtij sistemi është specialisti IT i kontrolluesit, i cili menaxhon llogaritë e punonjësve që realizojnë hedhjen e të dhënave. Në këtë program u konstatua së nuk është funksionale rubrika e *log-eve* për regjistrimin e veprimeve (modifikimeve, fshirjeve etj, të të dhënave), sipas Nenit 27, pika 2 gërma “ë” të Ligjit 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

BSHS hedh të dhëna përmes web-it në sistemin online të administruar nga AMF-ja. Për të aksesuar këtë sistem BSHS është pajisur nga AMF-ja, me një llogari të veçantë (emër/fjalëkalim), e cila përdoret nga punonjësi që kryen hedhjen e të dhënave.

Pranë kontrolluesit Byroja Shqiptare e Sigurimit konstatohet se, transferimi ndërkombëtar i të dhënave realizohet nëpërmjet sistemit *online* “Garantimi Online i Thirrjeve” (*OGC System*), administruar nga Këshilli i Byrove me server qendror në Bruksel. BSHS është pajisur nga ky Këshill me një llogari përdoruesi, (emër/fjalëkalim), për të aksesuar në mënyrë të sigurt përmes web-it këtë sistem dhe për të hedhur të dhënat përkatëse në të.

Gjatë kontrollit administrativ Zyra e Komisionerit u njoh me gjithë bazën ligjore dhe rregullative mbi të cilën kontrolluesi mbështet veprimtarinë e tij, kqyri dosje me përmbajtje trajtimi e dëmeve shëndetësore dhe materiale, u njoh me policat e sigurimit të detyrueshëm, procedurat e hartimit, formatimit, prodhimin dhe emetimin e tyre pranë Shoqërive të Sigurimit; intervistoi punonjës të departamenteve të ndryshme, u njoh me sistemet e përpunimit elektronik të të dhënave të kontrolluesit, sistemin e arkivimit etj.

Në lidhje me zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave personale” i ndryshuar, si dhe të akteve të miratuara nga Autoriteti i Komisionerit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale nga kontrolluesi, **konstatohet se:**

Në lidhje me zbatimin e parashikimeve të **nenit 7** të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, për përpunimin e të dhënave sensitive, kontrolluesi për shkak të veprimtarisë së tij, në zbatim të Ligjit Nr.10076/2009, mbledh dhe përpunon të dhëna sensitive, kryesisht të dhëna që lidhen me shëndetin (*kartela klinkie, diagnoza, vendime paaftësie të komisionit mjeko ligjor etj*), gjatë trajtimit të domsdoshëm, dhe në dobi të klientit në rastet e praktikave për dëmshpërblim, në rastet e “fondit të kompensimit” dhe “fondit të kartonit jeshil”.

Kjo kategori “të dhëna personale sensitive” nuk është deklaruar nga kontrolluesi në formularin e njoftimit, pranë Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi nuk realizonte trajtim të veçantë për këtë kategori të dhënash sensitive, sa i përket përpunimit manual, arkivimit dhe mbajtjes së dosjeve fizike.

Në lidhje me zbatimin e **neneve 8-9** të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Byroja Shqiptare e Sigurimeve* kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale brenda dhe jashtë vendeve të BE-së, për kategorinë e subjekteve të të dhënave, individë shkaktarë dhe përfitues dëmsh.

Ky transferim ndërkombëtar rrjedh nga detyrimet ligjore sipas neneve 42, 44 të Ligjit Nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme, Kretë, 30 Maj 2002, ku Byroja Shqiptare e Sigurimit është anëtare. Detyrimet ligjore lidhen me trajtimin e rasteve të aksidenteve të shkaktuara nga mjetet motorike me siguracion ndërkombëtar (karton jeshil).

Byroja si organizëm rregullativ mban marrëdhënie për trajtimin e rasteve të sigurimit me të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Byrove (44 vende), për rrjedhojë si kontrollues realizon transferim ndërkombëtar të të dhënave në vende me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të

dhënave dhe në vende me nivel jo të mjaftueshëm. Përveç, bazës ligjore të sipërcituar, kontrolluesi ka detyrim të përmbushë detyrimet e dokumentit “*Data Protection Agreements*”. Ky dokument është miratuar nga Këshilli i Byrove me qendër në Bruksel. Dokumenti i referohet Sistemit të Garantimit të Thirrjeve Online(OGC). Qëllimi i këtij kuadri rregullator është që sistemi OGC i detyrueshëm në veprimtarinë e Byrove, të garantojë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale dhe është bazuar në Direktivën e BE 95/46 dhe të gjitha Byrotë e secilit shtet kanë detyrimin për ta zbatuar. Duke qenë se “Garantimi Online i Thirrjeve” (OGC), do të bëjë të mundur shkëmbimin e informacionit, nëpërmjet *web tool*, të siguruar dhe mbështetur nga Këshilli i Byrove, ky i fundit do të jetë për herë të parë i përfshirë në procesin e shkëmbimit të të dhënave midis Byrove të Sigurimit.

Për këtë qëllim, Grupi i Punës Neni 29, në bashkëpunim me Këshillin e Byrove (Bruksel), ka përgatitur tre lloje të ndryshme marrëveshjesh, të cilat vendosin të drejtat dhe detyrimet midis Byrove dhe Këshillit të Byrove gjatë procesit të përdorimit të Sistemit, “Garantimi Online i Thirrjeve” (OGC) dhe konkretisht:

- Marrëveshje kontrollues-kontrollues;
- Marrëveshje për transferimin e të dhënave, e cila bën të mundur shkëmbimin e të dhënave personale midis Byrove të Shteteve Anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane (Eurozona-ZEE) dhe shteteve që ndodhen jashtë Eurozonës, si vende të treta në kuptim të Direktivës 95/46/KE;
- Marrëveshje përpunimi që duhet të nënshkruhet midis Byrosë (kontrollues të sistemit) dhe Këshillit të Byrove (përpunues, që vepron për llogari të Byrosë). Kjo marrëveshje vendos kushtet dhe detyrimet brenda të cilave Këshilli i Byrove do të lejohet të përpunojë të dhëna për llogari të Byrosë).

Byroja Shqiptare e Sigurimit, lidhur me implementimin e këtij kuadri ligjor evropian, i cili rrjedh nga anëtarësimi i saj në Këshillin e Byrove në Bruksel, është në fazat fillestare dhe nuk ka një produkt ku të evidentohet implementimi konkret i tij.

Sa i përket zbatimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, parashikuar nga nenet 12-17 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, konstatohet se, nga ana e kontrolluesit *Byroja Shqiptare e Sigurimeve*, subjekteve të të dhënave personale, u janë krijuar kushtet për ushtrimin e të drejtës për akses, ankesa, korrigjime, përditësime etj. Ushtrimi i këtyre të drejtave nga subjektet e të dhënave realizohet përmes paraqitjes së kërkesave pranë kontrolluesit në zyrën e protokollit.

Gjithashtu, pranë kontrolluesit Byroja Shqiptare e Sigurimit, bëhet hartimi i formatit tip të policave të sigurimit të detyrueshëm (*Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj palëve të treta (TPL), certifikatë ndërkombëtare e sigurimit motorik (karton jeshil) dhe police kufitare*), nëpërmjet të cilave mblidhen të dhënat personale për kategorinë klient. Në këtë proces por dhe gjatë trajtimit të dosjeve për kategorinë klient, në një procedurë dëmshpërblimi konstatohet se, kontrolluesi “*Byroja Shqiptare e Sigurimit*”, nuk bën informim të subjektit të të dhënave personale. Informimi i subjekteve të të dhënave

personale rrjedh nga detyrimi ligjor i nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si më poshtë vijon:

“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale”.

Gjatë kontrollit administrativ u verifikua dhe zbatueshmëria e Rekomandimit Nr. 14 datë 28/02/2014 të Komisionerit dhe rezultoi se:

Kontrolluesi ka zbatuar detyrimet e lëna në Rekomandim, me përjashtim të përditësimit të formularit të njoftimit dhe informimit të subjekteve të të dhënave.

Nga kontrolli administrativ i zhvilluar rezultoi se, kontrolluesi *Byroja Shqiptare e Sigurimeve* ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **(neni 21)** por, kontrolluesi nuk ka bërë përditësimin e këtij formulari lidhur me disa rubrika të deklaruara në mënyrë të pasaktë si më poshtë:

- Rubrikën 1, 2 dhe konkretisht, personin e kontaktit.
- Rubrikën 3.1, kategoritë e subjekteve të të dhënave personale.
- Rubrikën 4.1, kategoritë e të dhënave.
- Rubrikën 5.1, nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave sensitive.
- Rubrikën 6, qëllimi i përpunimit të të dhënave nuk është deklaruar i duhuri.

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi në kuadër të volumit të madh të dosjeve që administron nuk ka marrë masa të përshtatshme teknike (*ambiente arkivimi, kushte të përshtatshme fizike për ruajtjen dhe sigurinë e dosjeve*) në kundërshtim me parashikimet e nenit 27, 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 18, 21, 27, 28, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Byroja Shqiptare e Sigurimit*, gjatë mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale, nëpërmjet policave të sigurimit të detyrueshëm të realizojë informimin e subjekteve të të dhënave personale.

2. Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Byroja Shqiptare e Sigurimit”, të përditësojë Formularin e Njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit, sipas pjesës arësytuese të këtij rekomandimi.
3. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të përmirësojë programin, “sistemi i trajtimit të dëmeve”, duke përfshirë në të dhe rubrikën e log-ove (regjistrim të veprimeve), në funksion të sigurisë së të dhënave, dhe të krijojë ambiente të sigurta dhe të përshtatshme mbi sigurinë fizike të dosjeve të trajtuara, të cilat përmbajnë të dhëna personale të subjekteve.
4. Detyrimet parashikuara në pikat 1 dhe 3 të këtij rekomandimi, të realizohen brenda një afati kohor prej 45(dyzetë e pesë) ditësh, ndërsa detyrimi i parashikuar në pikën 2 të këtij rekomandimi, të realizohet brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh nga momenti i marrjes dijeni të rekomandimit.
5. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Byroja Shqiptare e Sigurimit duhet të marrë masa për implementimin e politikave të miratuara nga Këshilli i Byrove (në bashkëpunim me Grupin e Punës Neni 29), përsa i përket tre marrëveshjeve mbi mbrojtjen e të dhënave për përdorimin e sistemit, “Garantimi Online i Thirrjeve” (OGC), që siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet Byrove dhe Këshillit të Byrove me qëndër në Bruksel.
6. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
7. Me kalimin e afateve në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

